


# RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT ASFALTIMI I RRUGËVE LOKALE NË FSHATIN VITOMERICË



*Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Pejës.*

Organizatat e Shoqërisë Civile:  
Syri i Vizionit, OJQ Zana, OJQ Koha, Let's Do It Peja, Era Group, GWY-YMCA

RAPORT I MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË PROKURIMIT  
**ASFALTIMI I RRUGËVE LOKALE NË FSHATIN VITOMERICË**

**Monitorues dhe autor:** Abedin Imami, Tahire Gashi, Florida Gashi, Majlinda Kelmendi,  
Iliriana Kastrati, Adelina Kastrati dhe Dorina Gillogjani

**Fasilitatore:** Arton Demhasaj

Pejë, Maj 2019

---

# PËRMBAJTJA

5	HYRJE
6	METODOLOGJIA
8	KRONOLOGJIA E TENDERIT
9	KOMISIONI VLERËSUES
11	REKOMANDIME

---

# HYRJE

Ky raport është hartuar nga Grupi Monitorues i Organizatave Jo-Qeveritare të rajonit të Pejës, të cilët kanë përfituar dije dhe aftësi praktike përmes punëtorive për aplikimin e mësimit mbi monitorimin e prokurimit publik, të organizuara nga Platforma CiviKos në kuadër të aktivitetit të USAID Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM).

Grupi Monitorues ka bërë monitorimin e tenderit - “Asfaltimi i Rrugëve Lokale në Fshatin Vitomericë”. Ky tender është iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës. Ky projekt ishte i planifikuar që të realizohet gjatë vitit 2018/19. Pjesa më e madhe e buxhetit për këtë tender mbulohet nga Ministria e Infrastrukturës, por prokurimi për këtë tender është kryer nga Komuna e Pejës. Sipas planifikimeve buxhetore për realizimin e këtij projekti gjatë vitit 2018 nga MI-ja është janë planifikuar 160,720.00 € kurse për vitin 2019 nga kjo ministri janë planifikuar mjete në shumën prej 15,000.00 €. Pjesa tjetër e mbeture prej 48,150.20 €, është planifikuar të mbulohet nga Komuna e Pejës.

---

# METODOLOGJIA

Grupi i organizatave të shoqërisë civile që kanë përfituar nga punëtoritë, më tutje referuar si Grupi Monitorues ka përdorur një metodologji të kombinuar për monitorimin e aktivitetit të prokurimit. Fillimisht Grupi Monitorues përzgjedhjen e tenderit për monitorim e ka bërë duke u bazuar në indikatorë automatik të përzgjedhjes siç është ai i “*çmimi i ofertës fituese më i lartë se vlera e parashikuar e kontratës*” dhe “*rëndësisë që ka projekti për komunitetin*”. Gjatë fazës së monitorimit është bërë analiza cilësore e dokumenteve relevante që përmbajnë të dhëna primare zyrtare të aktivitetit të prokurimit, intervista me zyrtarin përgjegjës të prokurimit, si dhe monitorimi i vendpunishtes (vendit në të cilin zbatohet projekti/kontrata).

Grupi Monitorues ka vlerësuar zbatimin e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik duke u bazuar në një indikator kyç për vlerësimin e zbatimit të ligjit në procedurat dhe fazat e prokurimit, ku janë shqyrtuar dhe analizuar të gjitha dokumentet e nevojshme.

Gjithashtu janë zhvilluar dy vizita në terren për të parë për së afërmi punën në rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve të parapara në tenderë. Gjatë vizitës së dytë në terren që u zhvillua më 10 prill, ishte i pranishëm edhe një përfaqësues i komunitetit të Vitomerices i njoftuar nga z. Xhemë Berisha i cili na tregoi disa nga rrugët e asfaltuara.

**Indikatori:** Aktiviteti i prokurimit përfshinë të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RRUOP).

Vlerësimi i aktivitetit përmes këtij indikatori është bërë duke analizuar përmbajtjen e dokumenteve, si në vijim:

1. Planifikimi përfundimtar i prokurimit;
2. Kërkesa për iniciimin e aktivitetit të prokurimit nga njësi kërkuese;
3. Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve (B04);
4. Njoftimi për kontratë (B05);
5. Dosja e tenderit (B17);
6. Paramasa dhe parallogaria;
7. Regjistri i operatorëve ekonomik (OE) që e kanë pranuar dosjen e tenderit (B13);
8. Regjistri i tenderëve të dorëzuar;
9. Vendimi i formimit të Komisionit për hapje;
10. Procesverbali i hapjes së tenderit (B12);
11. Vendimi për krijimin e komisionit për vlerësimin e tenderëve;
12. Raporti i Vlerësimit të tenderëve (B36);
13. Njoftimi për dhënie të kontratës (B08);
14. Kontrata;
15. Vendimi për caktimin e menaxherit/es së projektit;
16. Plani për Menaxhimin e Kontratës.

---

## Pjesëmarrës të serisë së punëtorive ishin:

<b>EMRI DHE MBIEMRI</b>	<b>ORGANIZATA</b>
Abedin Imami	Syri i Vizion
Tahire Gashi	OJQ Zana
Florida Gashi	OJQ Koha
Majlinda Kelmendi	Lets do it Peja
Ilirjana Kastrati	Era Group
Adelina Kastrati	Era Group
Dorina Glllogjani	GWY-YMCA

Të gjitha këto dokumente Grupi Monitorues i ka siguruar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike dhe platformës elektronike për prokurim publik.

Grupi Monitorues është takuar pesë herë në zyret e OJQ Syri i Vizionit, me datat:

Dita I- 29.01.2019,

Dita II-14.03.2019.

Dita III-25.03.2019,

Dita IV-10.04.2019,

Dita V- 11.04.2019.

Grupi Monitorues me lehtësimin e Arton Demahsaj nga OJQ ÇOHU, kanë shkarkuar të gjitha dokumentet nga platforma elektronike e prokurimit, dhe së bashku kanë analizuar të gjitha dokumentet. Po ashtu Grupi Monitorues ka realizuar edhe vizitë në vend-punishte. Pas analizimit të gjitha dokumenteve, raporti i të gjeturave është dërguar tek Komuna e Pejës për komente, dhe pas këtij procesi është finalizuar raporti.

### Qëllimet e këtyre punëtorive janë:

- Aktivizimi i OJQ-ve lokale për të monitoruar tenderët në nivel komunal;
- Aftësimi i OJQ-ve që të analizojnë gjetjet nga tenderët dhe të zbulojnë keqpërdorimet potenciale në prokurim publik duke u mbështetur drejtpërdrejt nga lehtësuesit e angazhuar, dhe;
- OJQ-të të jenë të afta të përgatisin dhe publikojnë raporte mbi gjetjet e tyre gjatë monitorimit e prokurimit publik në nivel komunal.

---

# KRONOLOGJIA E TENDERIT

Komuna e Pejës më 05.10.2018, ka hapur tenderin për ndërtimin - asfaltimin e rrugëve lokale në fshatin Vitomeric me numër të prokurimit 635-18-6672-5-2-1. Ishte ndjekur procedura e hapur, ndërsa kriteret për dhënien e kontratës për punë ishte “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Nga Komuna e Pejës dhe Ministria e Infrastrukturës ishin ndarë 271.436.50 € për këtë tender.

Grupi monitorues në ueb-faqen e prokurimit elektronik (E-Prokurimi) ka gjetur disa dokumente si: dosjen e tenderit, paramasat dhe parallogaritë si dhe ofruesit. Por, në ueb-faqen e prokurimit elektronik mungonin edhe dy dokumente: Kontrata dhe Raporti i Vlerësimit të ofertave. Këto dokumente, grupi i ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues përmes procedurave të kërkuara në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike.

Grupi monitorues kanë analizuar dosjen e tenderit dhe ka shikuar kriteret e tij si dhe ka hulumtuar për tenderin fitues.

Kompania fituese ishte “Asfalti” Sh.p.k me vlerë 223.870,20 €

Më poshtë tabela me kompanitë konkurruese:

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik</b>	<b>Vlera totale e ofertës</b>
<b>1.</b>	N.N.,„Asfalti” Sh.p.k., 600017546	223.870,20
2.	N.T.SH.N. „Arfa”, 600201040	231.429,55
3.	“JOOS & KRASNIQI -BAZE “SH.P.K., 600490198	232.908,00
4.	”Menti” Shpk, 600017835	237.583,75
5.	“Mirusha Company” Sh.p.k, 600048137	246.956,80
6.	„Lika Trade” Sh.p.k., 600026555	257.334,75
7.	„Benita Company”Sh.p.k., 600233308	259.242,75



---

# KOMISIONI VLERËSUES

Kriteri i përzgjedhjes për fituesin ishte tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, në bazë të dhënave në e-prokurim, është verifikuar se a janë të gjithë operatorët që kanë ofertuar të përgjegjshëm. Në bazë të raportit të komisionit vlerësues, del që të gjithë operatorët ekonomik i plotësojnë kushtet, dhe konsiderohen të përgjegjshme. Andaj komisioni vlerësues, më datë 8 tetor 2018, e kishte rekomanduar si fitues operatorin që ishte më çmimin më të lirë, që në këtë rast ishte kompania Asfalti Sh.p.k me çmim 223.870,20 €.

Ky komision vlerësues është përbërë nga Milot Belegu – Kryetar i Komisionit, Granit Abdullahu – Anëtarë dhe Milot Gashi – Anëtarë.

Projekti “Asfaltimi i rrugëve në Vitomericë” është i ndarë në tri pjesë, e para është asfaltimi i rrugëve me gjerësi  $b=4.0\text{ m}^2$  me këto dimensione: gjatësia e rrugës  $L=(\text{m}^2\ 730)$ , gjerësia  $b=(\text{m}^2)\ 4.0$  dhe gjerësia e gjurmimit  $b=(\text{m}^2)\ 5.0$ .

Asfaltimi i rrugëve me gjerësi  $b= 3.5\text{ m}$ , kjo rrugë ka këto dimensione: gjatësia e rrugës  $L=(\text{m}^2)\ 3850$ , gjerësia  $b=(\text{m}^2)\ 3.5$  dhe gjerësia e gjurmimit  $b=(\text{m}^2)\ 4.5$ .

Asfaltimi i rrugëve me gjerësi  $b=3.0\text{ m}$  me këto dimensione: gjatësia e rrugës  $L=(\text{m}^2)\ 1630$ , gjerësia  $b=(\text{m}^2)\ 3.0$  dhe gjerësia e gjurmimit  $b=(\text{m}^2)\ 4.0$ .

## Qasja e vështirësuar në dokumente publike

Grupi ka shikuar nëse ka pasur ankesa nga ana e operatorëve të tjerë (jo fitues), tek autoriteti kontraktues, si shkallë e parë e ankesës. Është vërtetuar në bazë të dokumenteve që ekzistojnë në e-prokurim, dhe është verifikuar edhe përmes komunikimit zyrtarë me zyrën e prokurimit në Komunën e Pejës, se nuk ka pasur ankesë nga operatorët jo fitues tek autoriteti kontraktues – Komuna e Pejës.

Brenda afatit ligjor nuk ishte dorëzuar asnjë ankesë në OSHP në lidhje me këtë tender.

Pasi që kontrata nuk ishte e publikuar në e-prokurim, grupi monitorues dorëzuan ‘kërkesën për qasje në dokumente zyrtare’ në formë fizike, për kopjen e kontratës. Kërkesa u dorëzua me date 31.01.2019.

Më 12 shkurt 2019, Grupi Monitorues morri përgjigje nga zyrtarja për qasje në dokumente zyrtare në Komunën e Pejës, z. Ariana Lukaj e cila i njoftoi që kërkesa është aprovuar dhe mund të tërhiqen dokumentet në çdo kohë në Zyrën e Prokurimit. Më 20 shkurt, në Zyrën e Prokurimit, grupit monitorues iu ofruan dokumentet për shikim mirëpo meqenëse Grupit Monitorues i duhej kontrata në mënyrë që të analizohej, ata kërkuan që tu ofrohej kontrata në formë fizike, si dhe dosja e tenderit. Komuna premtoi që brenda javës do të kopjonin dokumentet e kërkuara por edhe pas 15 ditëve grupi monitorues nuk kishte pranuar përgjigje nga Komuna. Me datën 7 mars, Grupi Monitorues përsëri kishte vizituar zyrën e prokurimit dhe prapë pas disa arsyetimeve premtuan të njëjtën gjë.

---

Më datë 14 mars, Grupi Monitorues dërgoi një kërkesë tjetër duke kërkuar qasje në dosje dhe informata në lidhje me emrat e rrugëve të ndërtuara si dhe nëse kishte pasur ankesa nga operatorët ekonomik.

Pasi që grupi nuk u ftua për ti marrë dokumentet me 22 mars ata shkuan përsëri në zyrën e prokurimit dhe qëndruan aty përderisa morëm Kontratën dhe Raportin e vlerësimit të ofertave.

Në bazë të datave kur është dorëzuar kërkesa e parë për qasje në dokumente (31 janar) dhe ditës kur Grupi Monitorues ka arritur t'i ketë ato dokumente del që Komunës së Pejës i janë dashur 50 ditë për të ofruar dy dokumente bazike për monitorim të një procesi të prokurimit. Pra, kemi një shkelje të ligjit për qasje në dokumentet publike, i cili kërkon që institucioni t'i lejojë qasje në dokumente brenda 7 ditëve, apo në rastet më të komplikuara mund të kërkohej edhe 7 ditë të tjera shtesë, pra maksimumi qasje duhet të lejohet brenda 15 ditëve.

### **Në bazë të monitorimit nga Grupi Monitorues, të gjeturat kryesore janë:**

- *Data të ndryshme të vlefshmërisë së sigurimit të tenderit në kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe data të ndryshme brenda kantatës.*
- *Në një vend në kontratë (në faqen 14), vlefshmëria është deri më 31.01.2019 kurse në dosje 31.01.2020. Kjo mospërputhje gjendet edhe brenda kontratës ku figurojnë dy data të ndryshme.*
- *Emrat e rrugëve lokale të planifikuara për ndërtim dhe asfaltim nuk janë të shënuara në kontratë apo dosje të tenderit.*
- *Në pjesën e transparencës ka pasur vonesë për qasje në dokumente zyrtare.*

Me datë 25 mars, grupi monitorues realizoi vizitë e parë në teren. Meqenëse kishte mungesë të emërtimeve të rrugëve në kontaktua menaxherin e kontratës z. Agron Nikqi i cili na tha se do dërgonte një punëtor që të na i tregonte cilat rrugë ishin asfaltuar. Personi nuk erdhi asnjëherë mirëpo me ane të telefonit përafërsisht na udhëzoi për rrugët dhe pas konsultimit me banorë, gjetëm disa nga rrugët të cilat në baze shikimit nuk dukeshin të nivelizuara mirë.

Me 10 prill, patëm takim me menaxherin e prokurimit z. Xhemë Berisha, i cili në versionin e tij në lidhje me pyetjen për emrat e rrugëve në Vitomericë, theksoi se në kohën e fillimit të punimeve nuk ishin të caktuara ende emrat e rrugëve pasi që Komuna e Pejës është ende në proces të vendosjes së emrave të rrugëve dhe për këtë arsye emrat nuk janë të specifikuar në kontratë apo dosje të tenderit.

Sa i përket datave të ndryshme ai theksoi se është gabim teknik, por pa treguar për masat që do të ndërmerren për të rregulluar gabimin, ose edhe ndëshkimin e përgjegjësve.

---

# REKOMANDIMET

Pas monitorimit të këtij tenderi organizatat monitoruese kanë arritur të hartojnë këto rekomandime për Autoritetin Kontraktues – Komunën e Pejës dhe Zyrën e Prokurimit Publik në këtë komunë:

1. Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me njësitë e kërkesës duhet të publikojnë tenderët (dosjen e tenderit) me të dhënat e sakta, duke përfshirë emrat e saktë të rrugëve që do të asfaltohen. Në rastet kur rrugët nuk kanë emra, duhet të vendosen emërtimet e tyre që janë përdorur nga komuniteti që jeton aty për t'i mundësuar atyre të monitorojnë asfaltimin e rrugës përmes identifikimit më të lehtë të kontratës.
2. Kryetari i Komunës së Pejës duhet të sigurojë që Zyra e Prokurimit të mos bëjë gabime bazike, siç është gabimi në data, sepse ato mund të qojnë deri tek anulimi i tenderëve dhe zvarritja e projekteve. Datat në dosje të tenderit të vendosen me kujdes, duke u siguruar që të njëjtat data dhe afate kohore që janë përcaktuar në dosjen e tenderit të vendosen edhe në kontratën me Operatorin Ekonomik.
3. Afati kohorë për realizimin e punëve duhet të përcaktohet në mënyrë më reale dhe të saktë.
4. Të jenë më bashkëpunues dhe më transparent me organizatat jo-qeveritare, sidomos në përgjigje të kërkesave për qasje në dokumente publike.





